

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tuchel për kulturën e futbollit anglez: Nuk e di nëse do të kem kohë që t'i mësoj të mbajnë topin!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sport/tuchel-per-kulturen-e-futbollit-anglez-nuk-e-di-nese-do-te-kem-kohe-qe-ti--i587152
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 18:17:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 19:55:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fe98965e552e2d128c71eab02fec561ba00ec1cd11826364400bcca3e93b816c
TEKSTI	ee256e95d1f68beb42b9365d83497f762b5c6a56d3b421bc9866b49f20a001df
PAMJA	f7b4808b626fd731838c3cf11abfd97c38948187ec42a726bccfdb7aa6b1573f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2666813165b8aeaaae67d1a30f570b2df5285f3f7f510daf6158374dc6a1bc39
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2666813165b8aeaaae67d1a30f570b2df5285f3f7f510daf6158374dc6a1bc39>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Akuzohen për falsifikim të dokumenteve dhe peritum të padrejtë të pronave, dy ish-drejtorët e Kadastres t'ier mbeten në burg, një tjetër kalon në arrest shtëpie/A po i atr fundit](#)

Tuchel për kulturën e futbollit anglez: Nuk e di nëse do të kem kohë që t'i mësoj të mbajnë topin!



19 Shtator 2026, 21:55Sport TEMA



Thomas Tuchel pranon se mund të jetë tepër e vështirë për ekipin e tij të Anglisë që të praktikojë stilin e rafinuar të lojës me zotërim topi, të preferuar nga ekipet e tjera elitare ndërkombëtare.

Trajneri i Anglisë doli para mediave të premten për herë të parë pas humbjes së ekipit të tij në gjysmëfinalen e Kupës së Botës kundër Argjentinës dhe u përball me kritika lidhur me dështimin e skuadrës për të kontrolluar lojën gjatë turneut në Amerikë dhe Meksikë në verë.

Tuchel bëri një deklaratë të veçantë, duke thënë se pothuajse çdo tifoz i Anglisë me të cilin ishte takuar pas turneut kishte shprehur qëndrim pozitiv.

"E di se 99,9 për qind e tifozëve nuk flasin për zëvendësimet, ndryshimet taktike apo detajet taktike. Ata flasin për vendin ku e ndoqën ndeshjen kundër Meksikës dhe për energjinë e shfaqur në pjesën e dytë të ndeshjes me Kroacinë. Ata flasin për tensionin e madh gjatë ndeshjes sonë kundër Kongos dhe për vendet ku festuan. Ky është reagimi që marr unë. Kjo është ajo që kemi krijuar dhe kështu duhet të jetë", tha Tuchel.

Realiteti më i ashpër është se, pavarësisht se ishte vetëm dhjetë minuta larg finales, loja e Anglisë në ndeshjet kundër Argjentinës, Norvegjisë dhe Republikës Demokratike të Kongos nuk ishte gjithmonë mbresëlënëse.

Dhe, pasi kishte deklaruar në ditën e prezantimit të tij dy vite më parë se donte që skuadra e tij të luante një futboll të shpejtë dhe intensiv, si në Premier League, të premten ai pranoi se është e vështirë ta ruash atë stil gjatë gjithë një turneu të gjatë veror. "Nuk është ekonomike," tha gjermani.

Megjithatë, përpara ndeshjes së Ligës së Kombeve kundër kampionëve të botës, Spanjës, Tuchel pranoi se mendon që alternativa mund të jetë edhe më tepër e vështirë për t'u implementuar. "Jam duke e vrarë mendjen për këtë, sepse edhe nëse një skuadër e kontrollon lojën në Premier League, sa lojtarë anglezë ka në ato ekipe?", tha Tuchel.

"A është kjo në ADN-në tonë? A e vlerësojmë vërtet kontrollin e lojës? A është kjo diçka që na bën të ndihemi mirë gjatë një ndeshjeje? A është diçka që na vjen natyrshëm? A e kuptojmë vallë që nëse e kontrollojmë mesfushën, gjithçka është në rregull? Gjithçka varet nga mënyra se si tifozët anglezë e shijojnë një

ndeshje. Nuk mendoj se një tifoz anglez shkon në një ndeshje të Premier League-s dhe dëshiron të shohë një lojë të kontrolluar dhe një fitore 1-0 në minutat e fundit. Mendoj se, në thelb, lojtarët anglezë si dhe spektatorët, duan të luajnë në mënyrë agresive e sulmuese”, tha Tuchel.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Hetim ndaj Granit Xhakës në Zvicër, ja çfarë ka zbuluar prokuroria për kapitenin](#)

[Nga inferiorët italianë tek elita skoceze! Kush është shkodrani Sabah Kerjota, një nga risitë e Maran](#)

15:35 Sport / 3 komente

[U la jashtë listës së Kombëtares, "shpërthen" sulmuesi: Po rri urtë, më mirë të mos flas më...](#)

14:05 Sport / 6 komente

Nations League/ Maran: Nuk doja të eksperimentoja, Berisha dhe Broja janë gjithmonë të mirëpritur!

11:55 Sport / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.